



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primiheho/Prodato Received/Delivery	29.01.2024	4	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEMSTOK	526/2024		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1463/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetare; Jeton Koca dhe Ardit Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1463/2023, të datës 13.11.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike, "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Shfuqizohet** Pika një (I) e dispozitivit të Vendimit KA.nr.40/2023 të datës 03.11.2023 Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa lënda kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë.
- II. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi, sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 30.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër pikës I të dispozitivit Vendimit KA.nr.40/2023 të datës 03.11.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka arritur të konstatoi drejtë gjendjen faktike me arsyetimin se e

njëta me rastin e hyrjes në fuqi të Vendimit të datës 26.03.2021 të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka pasur përvojë punë pas diplomimit prej 2 vite, 11 muaj e 16 ditë ngase me datë 11.04.2018 ka marrë Diplomë Universitare-Master i Shkencave Juridike/Fakulteti Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*këtu e tuje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.12.202, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, me datë 12.12.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokolli 237/2024, të datës 08.01.2024, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1463/2023 të datës 30.11.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 30.11.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.40/2023 të datës 03.11.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; E-mailin e datës 05.10.2023 dërguar nga për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur; Diplomën e datës 13.07.2022 me shifër:91/22; Çertifikatë e datës 04.03.2019 me numër Ref.nr.03-18/407; Diplomë e datës 20.06.2008; Vendimin e datës 26.03.2021 të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin e datës 08.02.2018 të Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 01.11.2023; Ankesën e ankuesit të datës 06.10.2023; kërkesë për përgjigje në ankesë; Përgjigje në ankesë e datës 12.12.2023; Akt emërim i datës 19.02.2013; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 11.10.2022; E-mailin e datës 07.12.2023 dërguar nga për Vendimin e datës 08.02.2018 të Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së; Kërkesën e ankueses të datës 01.09.2023 të përcjellë tek Kërkesën e tek Njësia e Burimeve Njerëzore të SKPK-së; Fletë dorëzim i datës 06.10.2023; E-mailin e datës .06.12.2023 dërguar nga

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit duhet të kthehet në **rishqyrtim dhe rivendosje, sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja sipas Ndryshim Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 01.11.2023 është e punësuar në Këshillin Prokurorial të Kosovës, në pozitën e punës "Zyrtar Ligjor" me koeficientin e pagës 5.3 sipas sistemit të ri të pagave duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Lidhu me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 03.11.2023 dhe konstatoi se sipas pikës I të dispozitivit, ankueses i është njohur pjesërisht e drejta e kërkuar sikurse në ankesën e saj të datës 06.10.2023, ashtu që të njëjtës i është njohur kompensimi në mënyrë retroaktive nga data 05.07.2023 në diferencën e pagës ndërmjet koeficientit 6 dhe 7 sipas sistemit të ligjit të vjetër të pagave për nëpunësit civil, ndërsa kërkesa e ankueses e që e drejta

ISO 9001:2015
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës
për Shërbimin Civil të Kosovës

në kompensim material t'i njihet që nga data 26.03.2021 kur edhe ka hyrë në fuqi Vendimi me shifër KPK/Nr.193/2021 i nxjerrë nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit analizoi përmbajtjen e Vendimi me shifër KPK/Nr.193/2021 të nxjerrë nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe ka gjetur se sipas pikës 1 të dispozitivit është përcaktuar se: *Miratohet Plani i Personelit Administrativ për Vitin 2021*, kurse sipas pikës 2 të dispozitivit është përcaktuar se: *Harmonizohen, nivelizohen dhe ndryshohen koeficientët për pozitat si në vijim:* ku ndër të tjerash përfshihen edhe pozita "Zyrtar ligjor 1 me koeficient 6, i cili plotëson kriteret e kërkuara i harmonizohet koeficienti me pozitën Zyrtar Ligjor 2 me koeficient 2", dhe po ashtu Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankueses i është Ndryshuar dhe Plotësuar Akt emërimi me datë 11.10.2022 ku nga pozita "Sekretar Juridik" është caktuar në pozitën "Zyrtar Ligjor 1" me koeficient 6, ndryshim ky i cili është mbështetur mbi Vendimin e datës 08.02.2018 me shifër DSKPK/71/2018 të Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, e që sipas të cilit vendim parashihej që të gjithë Sekretarët Juridik të punësuar në prokurorinë e Shtetit të cilët kanë diplomë të Fakultetit Juridik të fituar sipas legjislacionit në fuqi, caktohen Zyrtar Ligjor 1 duke e ruajtur koeficient e pagës 6.

Ndër të tjerash Kolegji i këshilli ka gjetur se ankuesja posedon Diplomën e datës 20.06.2008 me shifër Nr.647 sipas të cilës dëshkohet se ankuesja ka diplomuar në Fakultetin Filozofik Dega e Etnologjisë dhe ka marr titullin Baçelor i Etnologjisë, ndërsa po ashtu posedon Çertifikatë të datës 04.03.2019 sipas së cilës dëshkohet se ankuesja me datë 11.04.2018 ka mbarur studimet Master pranë Fakultetit Juridik-Universiteti i Prishtinës dhe ka marr titullin Master i Shkencave Juridike Penale, kurse sipas Diplomës së datës 13.07.2022 që posedon ankuesja, dëshkohet fakti se e njëjta me datë 05.07.2022 ka mbaruar studimet themelore në prag ormanin LLB në Juridik pran Kolegjit Biznesi dhe ka marr titullin LLB në Juridik me Specializim në Penalo Juridik.

Po ashtu, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes shkresës së datës 12.12.2023 me rastin e kthimit të përgjigjes në ankesën e ankueses ndër të tjerash ka deklaruar se ankueses nuk mund t'i realizohet kompensimi retroaktiv nga data 26.03.2021 sikurse e njëjta pretendon, ngase citoj: *"ankuesja vetëm me datën 05.07.2023 kur edhe ka diplomuar plotësuar kushtet"*, ndërsa Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave përmes Vendimit të datës 03.11.2023 ka konstatuar se ankuesja ka mbaruar studimet themelore në fakultetin Juridik me datë 05.07.2022 (e që është konstatim i saktë sipas diplomës), ndërsa kanë vendosur që ankueses e drejta në kompensim retroaktiv t'i njihet vetëm nga data 05.07.2023 duke e lidhur me përmbushjen e afatit një (1)vjeçar pas diplomimit.

Kolegji i Këshillit nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi ka ardhur në përfundimin se në ndërmjet arsyetimit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të shprehur në Vendimi e datës 03.11.2023 të dhe përgjigjes së Njesisë së Burimeve Njerëzore të SKPKS-së të datës 12.12.2023, ka kundërthënie apo mos përputhje pasi që Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave arsyetimin për refuzimin e pretendimet ankimor të ankueses që kompensimi t'i njihet nga data 26.03.2021 e lidh me përmbushjen e afatit një (1)vjeçar pas diplomimit, kurse Njësia Burimeve Njerëzore nuk e mbron këtë konstatim por deklaroi që ankuesja ka diplomuar me datë 05.07.2023 e që mund të jetë një lëshim teknik ngase i njëjti konstatim nuk është i qëndrueshëm sipas diplomës së datës 05.07.2022.



Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ"* thekson faktin se pika I e dispozitivit të Vendimi KA.nr.40/2023 të datës 03.11.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës është e paligjshme, ngase të njëjtët arsyetimin që ankueses kompensimi t'i njihet pas përmbushjes së afatit një (1)vjeçar pas diplomimit nuk e mbështesin në ndonjë akt të brendshëm, respektivisht ky qëndrim sipas arsyetimit lënë të kuptohet se është pa mbështetje ligjore pasi që Vendimi me shifër KPK/Nr.193/2021 i nxjerrë me datë 26.03.2021 nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk e përcakton një çështje të tillë, respektivisht i njëjti vendim sipas pikës III të dispozitivit përcakton se: *"vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial dhe fillon të zbatohet sipas mundësive buxhetore për vitin 2021"*.

Kolegji i Këshillit vlerëson se është për tu theksuar fakti se formularët për kompensim retroaktiv dhe ndryshimin në listën e pagave të dërguara nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, nuk i ka ekzekutuar Thesari i Republikës së Kosovës, ashtu që sipas e-mailit të dërguar nga zyrtarja për ankuesen me datë 06.12.2023 theksohet se arsyeja e mos realizmit për këtë muaj është paqartësia e bazës ligjore ngase Divizioni i Pagave ka mandat të respektoj dhe zbatoj Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat e Zyrtarëve Publik, respektivisht nenin 45 paragrafi 2, ashtu që Thesari ka kërkuar sqarim nëse kërkesat e bëra me ndryshime për kompensim retroaktiv dhe koeficient janë në harmoni me legjislacionin e referuar të ri të pagave.

Prandaj nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, si dhe duke marra parasysh dispozitat e nenin 132 paragrafi 6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Ankesa nuk do të përkeqësoj situatën juridike në dëm të palës që ka paraqitur ankesë, përpos nëse shprehimisht është paraparë ndryshe me ligj"* ka vendosur që të shfuqizojë pikën I të dispozitivit të Vendimit KA.nr.40/2023 të datës 03.11.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa lënda e ankuesit kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë lidhur me pretendimin ankimor për kompensim retroaktiv, respektivisht Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e rishqyrtimit të ankesës së ankuesit duhet të marrë për bazë pikëpamjet juridike të këtij vendimi si dhe dispozitat e aplikuara ligjore në fuqi që ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret, ndërsa pika II e dispozitivit Vendimit KA.nr.40/2023 të datës 03.11.2023 e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave mbetet në fuqi, sikurse përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1463/2023

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SKPK-së;
- Arkivit të KPMSHCK-së

